

# SMITTSKYDDSBLAD

## Patientinformation

MRSA

Översättning till albanska

Version 2023-04-18

## SARM, informacion për pacientë

### Pse e kam marrë këtë informacion?

Disa analiza kanë treguar se ti ke një bakterie që është rezistente (ka fuqi rezistuese) ndaj antibiotikëve dhe ajo quhet SARM. Në këtë fletë informative mund të lexosh më shumë mbi atë se çka do të thotë kjo dhe çka duhet të kesh parasysh që të mos infektosh njerëz tjerë.

### Çka është SARM?

SARM do me thënë Staphylococcus aureus rezistent ndaj metilicilinës dhe është një variantë e baktereve stafilokoke që ka krijuar rezistencë ndaj disa antibiotikëve.

SARM mund të gjendet në lëkurë ose mukozë edhe pa qenë i sëmurë dhe kjo konsiderohet se ti je bartës. Ashtu si edhe stafilokokët e rëndomtë, SARM mund që nganjëherë të shkaktojë infeksione, si për shembull infeksione plagësh.

SARM nuk shkakton infeksione tjera ose të tilla që janë më të rrezikshme se stafilokokët e zakonshëm, mirëpo për trajtim të infektimit nga kjo duhet që të përdoren antibiotikë të posaçëm.

### Si infekton SARM?

SARM mund të infektojë ndërmjet njerëzve, para së gjithash nëpërmjet kontaktit të lëkurës, si për shembull nëpërmjet duarve. Bakteret poashtu mund të ngjiten në gjëra rreth nesh, si për shembull në mjete të stërvitjes, dhe në këtë mënyrë të shpërndahen tutje.

Një person që është bartës i SARM infekton rrallë të tjerët. Në disa gjendje numri i baktereve shtohet dhe në këtë mënyrë rritet edhe rreziku i përhapjes së infeksionit. Kjo quhet faktor rrezikues për përhapje të infeksionit.

Faktorë rrezikues për përhapje të infektimit për shembull, mund të jenë

- infeksione të lëkurës, si infektime të plagës, lungë ose impetigo (lia e derrit)
- plagë të hapura
- eksemë e përkeqësuar ose që kullon lëngë/eksemë në kanalën e dëgjimit
- disa sëmundje kronike të lëkurës
- katetrat ose stomt.

### A mund të shërohem nga SARM?

SARM në të shpeshtën e herave zhduket vetvetiu. Mirëpo mund të marrë kohë, prej disa muajve deri në një vit. Duhet që analizat të përsëriten në mënyrë që të merret vesh se bakteret janë zhdukur. Mjeku përgjegjës për SARM është ai që vendos se kur duhet të bëhen kontrollat dhe se kur bënë që ju të përfundoni t'u përmbaheni rregullave të sjelljes të cekura mëposhtë. Në të shpeshtën e herave kontrollimet përfundohen kur SARM nuk gjendet në dy analiza radhazi, brenda së paku një kohe tremuajshe.

### Çka duhet të kem parasysh që të mos infektoj të tjerë?

Gjëja më e rëndësishme që mund të bësh është të jesh i kujdesshëm me higjenë të duarve. Nëse nuk ke faktor rrezikues atëherë ti mund të jetosh si zakonisht dhe rreziku për të përhapur infeksionin është i vogël.

Fëmijët mund të vijojnë parashkollën dhe shkollën dhe të marrin pjesë në të gjitha aktivitetet. Prindi nuk është i detyruar të informojë parashkollën dhe shkollën që fëmiju është bartës i SARM. Fëmijët parashkollorë nganjëherë duhet të qëndrojnë në shtëpi, shih më poshtë rregullat e sjelljes që duhet t'u përmbaheni.

Nëse ti ke profesion punën me kafshë atëherë ti mund të marrësh këshilla të veçanta. Mjeku yt mund të këshillohet me mjekun për mbrojtje nga infeksioni..

### **Rregullat e sjelljes**

SARM është një sëmundje që paraqet rrezik për shoqërinë sipas ligjit mbi mbrojtje nga infeksionet. Prandaj ti duhet t'u përmbahesh disa rregullave që mjeku t'i cakton, të ashtuquajtura rregulla të sjelljes:

- Nëse ti ke faktorë rreziku për përhapje të infektimit atëherë ti duhet t'u përmbahesh disa rutinave të posaçme higjienike të cekura më poshtë.
- Nëse vuan nga një infeksion të gjatë të lëkurës, ke plagë të hapura ose eksemë që rrjedhin lëng atëherë ti nuk bënë të marrësh pjesë në aktivitete sportive në të cilat ka kontakte të shpeshta trupore ose të përdorësh lokale të përbashkëta stërvitjeje apo palestrën.
- Fëmijë parashkollorë duhet të qëndrojnë në shtëpi nëse vuajnë nga plagë të infektuara, impetigo (lia e derrit), eksemë të përkeqësuar ose që lëshojnë lëng.
- Nëse vuan nga një infeksion lëkure, plagë të hapura ose eksemë që lëshojnë lëng ti duhet të tregosh se je bartës i SARM në rast se bënë piercing, tatuazh, masazh, përkujdes jo mjekësor të shputave të këmbëve dhe trajtime të ngjashme të lëkurës ose mukozës.
- Ti duhet të tregosh se je bartës i SARM kur i drejtohesh shërbimeve mjekësore, dentistit dhe trajtimit mjekësor të shputave të këmbëve. Kjo vlen poashtu edhe nëse trajtohesh apo je nën përkujdesje në ndonjë shtëpi pleqsh apo në shtëpinë tënde. Nëse ti ndihmohesh për të blerë, pastrim, të ndash ilaçet ose të dalësh në shteti atëherë ti nuk ke nevojë të tregosh se je bartës i SARM.
- Ti që punon ose studion kujdes mjekësor dhe përkujdesje nuk bënë të marrësh pjesë në këtë nëse mjeku yt vlerëson se ti bart faktorë rrezikues për përhapje të infektimit.
- Ti duhet të mbash kontakt me mjekun tënd dhe të bësh analiza që janë të nevojshme.

Nëse të është caktuar t'i përmbahesh ndonjë rregulli të sjelljes të cilën ti e konsideron të gabueshëm atëherë ti mund të takosh mjekun për infektim në rajonin tënd.

### **Rutina të posaçme për ty që ke faktorë rrezikues**

Nëse ke faktorë rrezikues rreziku është më i madh që ti të përhapësh infektimin. Atëherë ti duhet të kesh parasysh gjërat në vijim:

- Të jesh i kujdesshëm me larje të duarve. Përdor peshqirin tënd dhe artikuj tuaj higjienikë.
- Mos u laj në pishinë njëkohësisht me të tjerët.
- Mbështill plagët me fashë dhe ndërro fashën nëse lëngu depërton në sipërfaqe.
- Nëse ke katetër atëher duhet që ato t'i kesh nën rroba.
- Laj duart pas kontaktit me plagën, fashën ose katetet.

### **Gjurmimi infeksionit**

Sipas ligjit për mbrojtje nga infeksionet ti duhet të bashkëpunosh për gjurmim të infeksionit. Kjo do me thënë se ti duhet të informosh personelin mjekësor ashtu që ata të mund të marrin vesh se kur, ku dhe si je infektuar dhe nëse ti mund të infektosh të tjerët.

Atë që ti tregon do të mbetet në besim (fshehtësi) dhe ata persona të cilëve ti u tregon nuk do të marrin vesh se kush je ti.

### **Mbi fletën informative për mbrojtje nga infeksioni**

Fleta informative për mbrojtje nga infeksioni është përpiluar nga shoqata e mjekëve për mbrojtje nga infektimi dhe vlen për tërë vendin.